Автомобилски училишен центар - Qendra shkollore e autotrafikut
"Браќа Петрушевски" на град Скопје - "Boro Petrushevski" e qytetit të Shkupit
Република Северна Македонија - Republika e Maqedonisë së Veriut
Бр.Nr. 02-17021 1
19.10 2026 год.viti
SKOPJE - SHKUP

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KËSHILLIT TË NXËNËSVE

DATA: 19.10.2026

ORA: 13:00

VENDI: KABINETI I GJUHËS

1. MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË NXËNËSVE, TË MBAJTUR MË 15.09.2026;

2. INFORMACION PËR ZGJEDHJEN E DY PËRFAQËSUESVE NGA RADHËT E MËSIMDHËNËSVE DHE TË NJË PËRFAQËSUESI NGA RADHËT E BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONALË, TË ZGJEDHUR NË MBLEDHJEN E KËSHILLIT ARSIMOR TË MBAJTUR MË 08.10.2026;

3. ZGJEDHJA E TRUPIT KOORDINUES DHE E KOMISIONIT PËR BESIM DHE BASHKËPUNIM;

4. INFORMACION PËR AKSIONIN HUMANITAR PËR DHURIMIN E RROBAVE DHE TË SENDEVE PERSONALE;

5. PREZANTIM DHE DISKUTIM PËR PARANDALIMIN DHE NJOHJEN E HERSHME TË DHUNËS.

Mbledhjen e drejtoi Kryetarja e këshillit të nxënësve, Mila Gjorgjieva. Të pranishëm ishin 28 kryetarë të klasave, përfaqësuesit nga radhët e mësimdhënësve Mimoza Giçevska, Koce Tapshanovski dhe Halime Demir-Horuni, si dhe përfaqësuesja nga radhët e bashkëpunëtorëve profesionalë, Elena Petrovska. Pasi u konstatua se kishte kuorum për zhvillimin e mbledhjes, Mila Gjorgjieva e hodhi në votim rendin e ditës të propozuar, i cili u miratua njëzëri nga të gjithë të pranishmit.

Pika e parë

Lidhur me pikën e parë, Kryetarja e këshillit të nxënësve, Mila Gjorgjieva, e hodhi për miratim procesverbalin e mbledhjes së Këshillit të Nxënësve, të mbajtur më 15.09.2026. Procesverbali u miratua njëzëri nga të gjithë të pranishmit.

Pika e dytë

Në kuadër të pikës së dytë, u njoftua se Këshilli Arsimor i shkollës kishte zgjedhur Koce Tapshanovskin dhe Halime Demir-Horunin si anëtarë të Këshillit të Nxënësve nga radhët e mësimdhënësve, ndërsa Elena Petrovskën si anëtare nga radhët e bashkëpunëtorëve profesionalë. Me këtë përfundoi mandati i mësimdhënëses Mimoza Giçevska, e cila u largua nga mbledhja e Këshillit të Nxënësve. Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë që janë anëtarë të Këshillit të Nxënësve marrin pjesë në punën e tij pa të drejtë vote.

Pika e tretë

Lidhur me pikën e tretë, që kishte të bënte me zgjedhjen e Trupit Koordinues dhe të Komisionit për Besim dhe Bashkëpunim, Mila Gjorgjieva informoi se në kuadër të Këshillit të Nxënësve funksionojnë këto dy organe. Trupi Koordinues përbëhet nga koordinatorët sipas viteve të shkollimit: Aner Qerimi, nga klasa I-8, koordinator i vitit të parë; Marko Velovski, nga klasa II-1, koordinator i vitit të dytë; Mario Jovanoski, nga klasa III-9, koordinator i vitit të tretë; dhe Andrea Cvetkova, nga klasa IV-1, koordinatore e vitit të katërt. Me propozimin e drejtorit të shkollës, Koce Tapshanovski u zgjodh përfaqësues i mësimdhënësve në Trupin Koordinues. Trupi Koordinues bashkërendon punën e koordinatorëve dhe të paraleleve. Kryetarja e këshillit të nxënësve, Mila Gjorgjieva, sqaroi se Komisioni për Besim dhe Bashkëpunim përbëhet nga sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Nxënësve, Jovan Krstevski, nga klasa II-2, një anëtar nga radhët e mësimdhënësve ose të bashkëpunëtorëve profesionalë që bëjnë pjesë në Këshillin e Nxënësve, si dhe një anëtar nga radhët e nxënësve të këtij këshilli. Anëtarët e Këshillit të Nxënësve propozuan dhe zgjodhën njëzëri psikologen Elena Petrovska, nga radhët e bashkëpunëtorëve profesionalë, dhe Mila Gjorgjievën, nga klasa IV-2. Komisioni për Besim dhe Bashkëpunim mbikëqyr disiplinën, etikën dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore.

Pika e katërt

Lidhur me pikën e katërt, nxënësit u informuan se në shkollën tonë, që nga viti i kaluar, ka nisur një aksion humanitar për dhurimin e veshjeve dhe të sendeve personale, i mbështetur në vlerat që kultivojmë: solidaritetin, barazinë dhe respektin. Në frymën e vlerave bashkëkohore evropiane, gjithnjë e më shumë njerëz zgjedhin të dhurojnë dhe të përdorin sende të dorës së dytë, jo nga nevoja, por nga ndërgjegjësimi. Kjo mënyrë jetese ndërthur kujdesin për njerëzit me kujdesin për mjedisin. Në shumë vende të botës, veshjet e përdorura janë pjesë e kulturës, jo sepse njerëzit nuk kanë mundësi të blejnë veshje të reja, por sepse dëshirojnë të jetojnë në mënyrë më të përgjegjshme. Të dhurosh dhe të pranosh diçka të dorës së dytë do të thotë të jetosh me përgjegjësi dhe vetëdije. Mund të dhurojmë veshje të pastra dhe të ruajtura mirë, shalla, kapele, xhaketa dhe këpucë. Nga data 19.10.2026 deri më 22.10.2026, salla e sportit do të jetë e hapur për këdo që dëshiron të sjellë ose të marrë veshje. Ky nuk do të jetë thjesht një aksion i zakonshëm, por një mësim për humanizmin, përmes të cilit të gjithë do të mësojmë se të ndash me të tjerët është forcë, se të gjithë jemi të barabartë dhe se secili meriton mbështetje.

Pika e pestë

Lidhur me pikën e pestë të rendit të ditës, Kryetarja e këshillit të nxënësve, Mila Gjorgjieva, së bashku me përfaqësuesen nga radhët e bashkëpunëtorëve profesionalë, psikologen e shkollës Elena Petrovska, biseduan me nxënësit për rëndësinë e parandalimit dhe të njohjes së hershme të dhunës. Nxënësit u njohën me rëndësinë e identifikimit dhe të raportimit në kohë të dhunës, si dhe me përmbajtjen dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren për mënyrën e raportimit dhe

të mbrojtjes së nxënësit viktimë të çdo forme dhune, abuzimi dhe neglizhimi. U theksua rëndësia e respektit, tolerancës dhe mbështetjes së ndërsjellë për krijimin e një mjedisi të sigurt shkollor.

Pas përfundimit të pikës së pestë, mbledhja u mbyll pa vërejtje të tjera.

Kryetarja e këshillit të nxënësve:

Mila Gjorgjieva

J. Mila

Sekretari i këshillit të nxënësve:

Jovan Krstevski

Jovan K.

Përktheu:

Jehona Asani